

SHPALLJE PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE VAKANDE

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015” Për vetqeverisjen vendore “(i ndryshuar), ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar), Bashkia Elbasan shpall procedurën e konkurimit për pozicionin :

Aktor, Sektori Teatrit në Drejtorinë e Artit dhe Kulturës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit

I. Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Të interpretojë role bazuar në skenarë të shkruar ose të interpretuar .
2. Të marrë pjesë në audicione për role të ndryshme
3. Të përgatitet për rolin përmes studimeve të karakterit dhe analizës së skenarit.
4. Të marrë pjesë në promovime, intervista ose evente të tjera publike sipas nevojës.

1.1 KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë arsim të lartë;
3. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
4. Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;
5. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
6. Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;

Të plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si vijon:

1. Të preferohet diplomë të nivelit të parë ose të dytë në artin dramatik, aktrim, regji ose në fusha të ngjashme (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
2. Të kenë aftësi të mira interpretimi dhe komunikimi.
3. Të ketë eksperiencë në aktrim (teatër, film, apo në television).
4. Të ketë fleksibilitet dhe kreativitet në zjelljen e roleve të ndryshme .

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Elbasan dokumentacionin si mëposhtë

- a. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

- b. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f. Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g. Raport mjekësor që vërteton se është i aftë për punë;
- h. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Elbasan, brenda datës 04.08.2025.

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Bashkia e Elbasanit shpall procedurat e konkurimit për vendet e lira të punës :

Shofer /manovrator në Drejtorinë Shkumbin e Lartë pranë Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale;

Punëtor , Sektori Pastrimit pranë Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- 1) Të jetë shtetas shqiptar;
- 2) Të ketë arsim të mesëm;
- 3) Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
- 4) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
- 5) Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;
- 6) Aplikanti që do të aplikojë për pozicionin e punës shofer duhet të jetë I pajisur me leje drejtimi B dhe C.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- 1) Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
- 2) Curriculum Vitae;
- 3) Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- 4) Çertifikatë e përbërjes familjare;
- 5) Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
- 6) Fotokopje e librezës së punës;
- 7) Raport mjeko-ligjor;
- 8) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- 9) Dy fotografi (2.5 x 3.5 cm)

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e aplikimit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e publikimit të njoftimit, pranë zyrës së informacionit, Bashkia Elbasan

